REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë **07.10.2026** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: "Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 181, të vitit 2025, me të pandehur **Fation Lulash Bushgjokaj**, **Petrit Ramiz Hoxha** alias **Petrit Çakraj**, **Kristë Bushgjokaj** dhe **Aleksandër Bushgjokaj**.".
2. Në seancën e datës **27.11.2026** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin nr. **157**, datë **27.11.2026**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 181, të vitit 2025, në ngarkim të të pandehurve:
    1. **Fation Bushgjokaj,** i cili akuzohet për veprat penale "*Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit*", kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grupi i strukturuar kriminal*", *"Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 109/3, 28/4, 333/a/2 dhe 334/2 të Kodit Penal**.**
    2. **Petrit Hoxha** alias **Petrit Çakraj,** i cili akuzohet për veprat penale "*Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit*", kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal"*, parashikuar nga nenet 109/3, 28/4, 333/a/2 dhe 334/2 të Kodit Penal.
    3. **Kristë Bushgjokaj,** i cili akuzohet për veprat penale *"Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit",* kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grupi i strukturuar kriminal*", *"Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 109/3, 28/4, 333/a/2 dhe 334/2 të Kodit Penal.
    4. **Aleksandër Bushgjokaj,** i cili akuzohet për veprat penale *"Rrëmbimi*

ose mbajtja peng e personit", kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, "*Grupi i strukturuar kriminal*", *"Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga nenet 109/3, 28/4 dhe 333/a/2 dhe 334/2 të Kodit Penal.

3. Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për t'u hedhur në short.

4. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Tiranë, më datë 27.11.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar